




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbështetje të nenit 4 dhe 27 të Ligjit Nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 3 paragrafi 7 Ligjit nr.03/l - 149 për Shërbimin Civil dhe nenit 25 të Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datën 27 korrik 2015, nxjerr

UDHËZIM ADMINISTRATIV 02/2015

PËR PERIUdhËN TRANZITORE (KALIMTARE) PREJ FILLIMIT DERI NË KALIMIN E PËRGJEGJËSIVE NË NIVEL TË GJYKATAVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

- 1.1 Qëllimi i këtij udhëzimi është rregullimi i përgjegjësive dhe kriterëve unike për ri caktimin dhe transferimin dhe avancimin e nëpunësve civil të cilët ngelin tepriçë në Sekretariat për shkak të delegimit të përgjegjësive në çështjet e personelit, buxhetit dhe financave, prokurimit dhe logjistikës nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës tek gjykatat themelore, Gjykatën e Apelit, dhe Gjykatën Supreme duke përfshirë dhe Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.
- 1.2 Ky udhëzim përcakton kushtet, kriteret dhe procedurat unike të transferit të përhershëm, procedurat unike për avancimin në karrierë dhe rekrutimit të nëpunësve civil nga Sekretariati në gjykata, nga një gjykatë në një gjykatë tjetër apo brenda gjykatës.
- 1.3 Dispozitat e këtij udhëzimi janë të obligueshme për zbatim për Sekretariatit dhe gjykatat.

Neni 2

Përcaktimi i pozitave tepriçë në Sekretariat

- 2.1 Një numër i nëpunësve civil në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës do të mbetet tepriçë për shkak të delegimit të përgjegjësive nga fusha e personelit, buxhetit dhe financave, prokurimit dhe logjistikës tek gjykatat.
- 2.2 Numrin e pozitave të nevojshme për çdo njësi të Sekretariatit e përcakton struktura organizative e Sekretariatit.
- 2.3 Çdo pozitë që nuk është brenda strukturës organizative të Sekretariatit konsiderohet e panevojshme (tepriçë).
- 2.4 Të gjitha pozitat e tepërta në njësitë në Sekretariat që preken nga decentralizimi së pari do të ri-caktohen në Sekretariat. Komisioni i themeluar sipas nenit 3 të këtij Udhëzimit do të zhvillojë procedura në lidhje me zbatimin e këtij paragrafi të cilat do të jenë të ditura paraprakisht.

- 2.5 Përjashtimisht nga paragrafët e mësipërm të këtij neni, zyrtarët që janë përgjegjës për punët që janë specifike vetëm për KGJK-në nuk i nënshtrohen procesit të rregulluar me këtë Udhëzim.

Neni 3

Kriteret që përcaktojnë mbetjen e nëpunësve civil në Sekretariat dhe delegimin në gjykata

- 3.1 Në rast se ka më tepër nëpunës civilë se struktura e organizative e Sekretariatit, Këshilli formon Komision prej tre (3) anëtarëve nga radhët e anëtarëve të Këshillit i cili është kompetent për të përcaktuar se kush prej nëpunësve civil mbetin në Sekretariat.
- 3.2 Kriteret për përcaktimin e nëpunësve civil të cilët mbetin në Sekretariat janë:
- 3.2.1 Përvojë pune më të gjatë në pozitën përkatëse;
 - 3.2.2 Nëse nëpunësit civilë kanë përvojën të njëjtë në pozitën përkatëse përparësi do të ketë zyrtari me moshë më të vjetër.
- 3.3 Zyrtarët që kanë mbetur pa sistemuar dhe duhet të delegohen në gjykata e tjera bëhet përmes shortit.
- 3.4 Në qoftë se pas tërheqjes së shortit zyrtarët e caktuar kanë shprehur vullnetin për ndërrim me kolegët e tyre një gjë e tillë do të bëhet e mundur.
- 3.5 Zyrtarët që kanë mbetur të pa sistemuar dhe kanë kërkesë për t'u sistemuar jashtë territorit të Prishtinës mund të transferohen në pozitë përkatëse nëse ka pozitë të lirë.

Neni 4

Hapja e pozitave të lira për të gjithë

- 4.1 Nëse pozitave të lira në gjykata, nuk mund të plotësohen përmes procedurës së transferimit dhe avancimit në karrierë, atëherë ato pozita do të publikohen me konkurs të hapur për të gjithë.
- 4.2 Asnjë pozitë e lirë nuk mund të publikohet nëse me atë pozitë tejkalohet numri i përgjithshëm i pozitave të parapara sipas strukturës organizative të gjykatës.

Neni 5

Dispozitat kalimtare

- 4.3 Nga dita e aprovimit të të gjitha akteve normative që përkojnë me decentralizimin nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Sekretariati i KGJK është i obliguar me se largu deri me date 31 Dhjetor 2015 që brenda afatit tre deri në gjashtë muaj të përfundojë me ri caktimin dhe plotësimin e të gjitha pozitave sipas strukturës organizative të gjykatave.
- 4.4 Periudha tjetër tre deri në gjashtë muajsh do të jetë me trajnime për ngritjen e nëpunësve civil në gjykata që punojnë në fushën e personelit, buxhetit dhe financave, prokurimit dhe logjistikës.

4.5 Nga momenti i përfundimit të trajnimeve për zyrtarët e personelit në gjykata, ata menjëherë do të i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre në pajtim me udhëzimin administrative për delegimin e përgjegjësive nga Sekretariati tek gjykatat.

4.6 Kur Sekretariati të vlerëson se janë plotësuar gjitha pozitat dhe janë ngritur kapacitetet profesionale të nëpunësve civil që punojnë në fushat buxhetit dhe financave, prokurimit dhe financave do të i nxjerrë një vendim se kur i kalohen kompetencat gjykatave në këto fusha.

Neni 6

Zbatimi i këtij udhëzimi

6.1 Këshilli Gjyqësor i Kosovës obligon Sekretariatit e KGJK-së për zbatimin e këtij udhëzimi.

6.2 Sekretariati i KGJK-së i raporton Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Data:

Enver Peci

Kryesuesi i KGJK-së

